

# UNIVERSITETI I SË ARDHMES

Platformë Strategjike për Rektor

Universiteti i Tetovës 2026-2029

**PROF. DR. FEHARI RAMADANI**

Kandidat për Rektor në Universitetin e Tetovës

"Një Universitet Modern. Një Vizion Evropian. Një Epokë e Re Akademike."

VERSION PREMIUM - EXECUTIVE PLATFORM

# Arkitektura e Transformimit 2026-2029

Një dokument programor me strukturë institucionale, gjuhë udhëheqëse dhe dizajn premium për prezantim publik e akademik.

<p><b>I</b> <b>Ndërkombëtarizim</b> Rrjete akademike shqiptare, rajonale dhe evropiane.</p>	<p><b>II</b> <b>Kërkim &amp; Laboratorë</b> Laboratorë si qendra ekspertize, shërbimi dhe financimi.</p>	<p><b>III</b> <b>Universitet Smart</b> Digjitalizim, IA, UT-Hub dhe sistem One-Stop-Shop.</p>
<p><b>IV</b> <b>Industria &amp; Ekonomia</b> Partneritete reale me sektorin privat dhe publik.</p>	<p><b>V</b> <b>Green &amp; Tech Campus</b> Kampus modern, efikas dhe i qëndrueshëm.</p>	<p><b>VI</b> <b>Gjuhë &amp; Kulturë</b> Diplomaci akademike dhe rol rajonal i universitetit.</p>
<p><b>VII</b> <b>Studenti në Qendër</b> Media universitare, zë studentor dhe përfshirje reale.</p>	<p><b>VIII</b> <b>Transparencë</b> Llogaridhënie, meritokrasi dhe besim institucional.</p>	<p><b>IX</b> <b>Publikime Shkencore</b> Fond për Scopus/WoS, konferenca dhe RSO.</p>

**Teza qendrore:** Universiteti i Tetovës nuk duhet të jetë vetëm institucion mësimor, por qendër e dijes, kërkimit, inovacionit dhe shërbimit për shoqërinë.

ROADMAP 2026-2029

# Nga Vizion në Zbatim

<b>100 ditët e para</b>	Rregullore, komisione, RSO, thirrje të para, platforma Transparenca UT dhe plan digjitalizimi.
<b>Viti I</b>	Funksionalizim i mekanizmave të rinj: UT-Hub, mobilitet, raportim publik, projekte laboratorike dhe partneritete.
<b>Viti II</b>	Shtirirje e modelit kërkimor, rritje e projekteve ndërkombëtare, integrim i IA dhe bashkëpunime me industrinë.
<b>Viti III</b>	Konsolidim i universitetit si qendër rajonale akademike, kërkimore, kulturore dhe inovative.

## Fokusi i dizajnit institucional

Ky version e paraqet platformën si dokument të nivelit të lartë: i lexueshëm, i strukturuar, i plotë dhe i përshtatshëm për prezantim publik, akademik dhe institucional.

## PËRMBAJTJA

# Struktura e Platformës

1. Hyrje
2. Shtylla I - Ndërkombëtarizimi dhe hapja ndaj botës
3. Shtylla II - Laboratorët dhe universiteti kërkimor
4. Shtylla III - Inovacioni, teknologjia dhe inteligjenca artificiale
5. Shtylla IV - Ndërlidhja me industrinë dhe ekonominë
6. Shtylla V - Kampusi modern dhe i qëndrueshëm
7. Shtylla VI - Gjuha, kultura dhe diplomacia akademike
8. Shtylla VII - Studenti në qendër dhe media universitare
9. Shtylla VIII - Transparenca dhe llogaridhënia
10. Shtylla IX - Publikime shkencore, konferenca dhe integriteti akademik
11. Anex 1 - Rubrikë vlerësimi
12. Anex 2 - Dokumentet për aplikim
13. Përmbyllje

Universiteti i Tetovës - Një Universitet Modern, Kërkimor dhe i Hapur ndaj Botës (2026-2029)

# HYRJE

---

Një vizion i ri për një universitet modern, kërkimor dhe të hapur ndaj botës.



# HYRJE

Universiteti i Tetovës është arritja më e madhe historike e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Ky institucion së bashku me institucionet tjera rsimore dhe shkencore në gjuhën shqipe janë të një rëndësie të veçantë për identitetin kulturor, gjuhësor, ekonomik dhe teknologjik të shqiptarëve dhe të vendit në tërësi.

Universiteti i Tetovës si prirës i këtyre zhvillimeve luan rol të rëndësishëm në zhvillimin tonë si shoqëri në tërësi. Sot kemi kapacitete të rëndësishme akademike, staf të përgatitur dhe potencial të madh për t'u shndërruar në një universitet modern evropian i përgatitur për sfidat globale të ndërthurura me digjitalizimin dhe inteligjencën artificiale. Megjithatë, për të arritur këtë, ne kemi nevojë për një **vizion të qartë, guxim për reforma dhe një qasje të re zhvillimore.**

Platforma ime synon që Universiteti i Tetovës të mos mbetet vetëm një institucion mësimor, por të bëhet një **qendër e dijes, kërkimit, inovacionit dhe shërbimit për shoqërinë.**

SHTYLLA I

# 1. NDËRKOMBËTARIZIMI DHE HAPJA NDAJ BOTËS

Nga bashkëpunimet formale në partneritete reale ndërkombëtare.

## SHTYLLA I

# 1. NDËRKOMBËTARIZIMI DHE HAPJA NDAJ BOTËS

Një universitet modern nuk mund të zhvillohet i izoluar. Ai duhet të jetë pjesë aktive e rrjeteve rajonale dhe ndërkombëtare, ku shkëmbimi i dijes, përvojës dhe projekteve është thelbësor për rritjen e cilësisë në arsim dhe kërkim shkencor.

Angazhimi im është që Universiteti i Tetovës të pozicionohet si një **aktor i rëndësishëm në hapësirën akademike shqiptare, rajonale, evropiane dhe botërore**, duke kaluar nga një model bashkëpunimi formal në një model aktiv dhe funksional.

Çfarë do të bëjmë konkretisht:

## • Forcimi i bashkëpunimit me universitetet në Shqipëri dhe Kosovë

Do të kalojmë nga marrëveshjet formale në projekte konkrete të përbashkëta në fushën e kërkimit, mësimdhënies dhe aktiviteteve studentore.

## • Krijimi i rrjetit të integruar ndëruniversitar shqiptar (RMV-Kosovë-Shqipëri) "Sami Frashëri"

Universiteti i Tetovës do të marrë rol udhëheqës në ndërtimin e një platforme të përbashkët rajonale, e cila do të shërbejë si bazë për:

- aplikime të përbashkëta në projekte evropiane (Horizon Europe, Erasmus+, IPA, Interreg, COST, etj.)
- rritje të fondeve për kërkim shkencor
- rritje të publikimeve dhe bashkëpunimit akademik
- shfrytëzim të përbashkët të kapaciteteve laboratorike dhe ekspertizës

Kjo është mënyra më efektive për ta bërë universitetin më të fortë, më konkurrues dhe më të dukshëm në nivel ndërkombëtar.

## • Zgjerimi i programeve të mobilitetit akademik

Do të rritet numri i studentëve dhe stafit që përfitojnë nga:

- programet e këmbimit semestral
- mobiliteti afatshkurtër
- praktikat dhe trajnimet ndërkombëtare

## • Organizimi i konferencave ndëruniversitare rajonale dhe ndërkombëtare

Universiteti do të bëhet një qendër aktive e organizimit të konferencave shkencore dhe studentore, duke nxitur shkëmbimin e ideve dhe prezantimin e kërkimeve.

## • Angazhimi i profesorëve dhe ekspertëve ndërkombëtarë

Do të ftohen profesorë nga universitete të njohura për:

- ligjërata tematike- bashkëpunime kërkimore
- mentorim akademik

## Zhvillimi i shkollave verore ndërkombëtare

Do të organizohen programe të dedikuara për studentë të huaj në fusha të ndryshme, duke promovuar:

- gjuhën shqipe
- kulturën dhe identitetin
- Kapacitetet akademike të universitetit

• **Rritja e pranisë së studentëve ndërkombëtarë**

Do të krijohen programe dhe kushte që e bëjnë Universitetin e Tetovës një destinacion tërheqës për studentët e huaj.

## Rezultati i pritshëm

Përmes kësaj qasjeje:

Universiteti i Tetovës do të rrisë ndjeshëm praninë dhe ndikimin ndërkombëtar

do të rrisë fondet për kërkim dhe projekte

do të ndërkombëtarizojë stafin dhe studentët dhe

do të forcojë pozicionin e tij si një universitet modern dhe konkurrues në rajon dhe më gjërë

## LABORATORËT - NGA HAPËSIRA MËSIMORE NË QENDRA EKSPERTIZE, SHËRBIMI DHE ZHVILLIMI

Laboratorët e universitetit janë një nga asetet më të rëndësishme që posedojmë, por aktualisht nuk shfrytëzohen në potencialin e tyre të plotë.

Angazhimi im do të jetë që laboratorët të transformohen në qendra të mirëfillta kërkimore, profesionale dhe shërbimi, të akredituara, të cilat do të jenë në shërbim të shtetit, ekonomisë, ndërmarrësisë dhe kërkimit shkencor.

Laboratorët nuk do të jenë më vetëm hapësira mësimore - por motor i zhvillimit të universitetit

Çfarë do të ndryshojë konkretisht

Laboratorët do të funksionojnë mbi një model të integruar me tre shtylla kryesore:

### 1. Shërbim për institucionet publike

Universiteti do të bëhet një partner i drejtpërdrejtë i sektorit publik, duke ofruar ekspertizë të bazuar në shkencë.

• **Analiza dhe ekspertiza për:**

- sigurinë ushqimore
- mbrojtjen e mjedisit
- shëndetin publik
- legjislacionin
- sigurinë kibernetike
- zhvillimin social dhe shoqëror

- **Mbështetje për politika publike:**

- studime dhe analiza për vendimmarrje
- rekomandime për përmirësim të legjislacionit
- bashkëpunim me ministritë dhe agjencitë

- **Analiza dhe verifikime sipas standardeve:**

- kontroll i përputhshmërisë me standardet kombëtare dhe të BE-së
- verifikim i produkteve dhe proceseve
- krijimin e politikave adaptuese në përputhshmëri me zhvillimet shoqërore

Universiteti do të ketë një **rol real dhe aktiv në vendimmarrje dhe zhvillimin e politikave publike**

## 2. Shërbim për sektorin privat

Në të njëjtën kohë, universiteti do të ndërtojë një bashkëpunim të qëndrueshëm me sektorin privat, duke u shndërruar në një **partner strategjik të industrisë dhe ekonomisë**.

- **Analiza laboratorike dhe kontroll cilësie:**

- analiza fiziko-kimike dhe mikrobiologjike
- certifikim i produkteve dhe proceseve
- përputhshmëri me standardet ndërkombëtare

- **Zgjidhje teknike për problemet e industrisë:**

- analizë e sfidave në prodhim
- rekomandime për përmirësim teknologjik
- zhvillim i produkteve të reja

- **Optimizim i proceseve prodhuese:**

- rritje e efikasitetit dhe produktivitetit
- reduktim i kostove dhe humbjeve
- implementim i teknologjive moderne

Universiteti bëhet partner **real i ekonomisë**, duke ndihmuar drejtpërdrejt zhvillimin e bizneseve.

## NDËRLIDHJA ME FINANCIMIN - LABORORËT SI BURIM I QËNDRUESHËM I TË ARDHURAVE

Ky model nuk ka vetëm rol akademik - ai krijon edhe një **model të qëndrueshëm financiar për universitetin**.

Përmes shërbimeve për sektorin publik dhe privat, laboratorët do të gjenerojnë të ardhura përmes:

- kontratave me institucione publike
- tarifimit të analizave dhe shërbimeve laboratorike
- projekteve të përbashkëta me kompani
- aplikimeve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare

## Cikli i zhvillimit të qëndrueshëm

Të ardhurat e gjeneruara do të rikthehen në universitet për:

- modernizimin e pajisjeve laboratorike
- zhvillimin e teknologjive të reja
- financimin e projekteve kërkimore
- mbështetjen e stafit dhe studentëve
- krijimin e qendrave të reja laboratorike

Laboratorët kalojnë nga një kosto për universitetin në një **motor vetëfinancimi dhe zhvillimi të vazhdueshëm**.

## Përfshirja e studentëve

Studentët do të përfshihen drejtpërdrejt në:

- analiza laboratorike reale
- projekte kërkimore dhe aplikative
- bashkëpunime me institucione dhe kompani

Kjo i përgatit ata realisht për tregun e punës, rrit partneritetin me kompanitë dhe krijon mundësi më të mira për punësim.

**Ndërlidhja strategjike: - Universitet - Institucione publike - Ekonomi -**

Ky model krijon një sistem të integruar ku:

- sektori publik përfiton nga ekspertiza shkencore
- bizneset përfitojnë nga zgjidhjet teknike
- universiteti gjeneron të ardhura dhe zhvillon kërkimin
- studentët fitojnë përvojë praktike

## REZULTATI FINAL

Nëpërmjet kësaj qasjeje:

universiteti bëhet më i qëndrueshëm financiarisht

kërkimi shkencor bëhet i aplikueshëm dhe i vazhdueshëm

rritet ndërkombëtarizimi dhe konkurrueshmëria


universiteti përgatitet për sfidat moderne dhe kërkesat e tregut të punës

SHTYLLA III

# 3. INOVACIONI, TEKNOLOGJIA DHE INTELIGJENCA ARTIFICIALE

---

Universiteti Smart, inovacioni dhe inteligjenca artificiale.



## SHTYLLA III

## 3. INOVACIONI, TEKNOLOGJIA DHE INTELIGJENCA ARTIFICIALE

Në një kohë kur zhvillimet teknologjike po ndryshojnë me shpejtësi mënyrën se si mësojmë, punojmë dhe zhvillohemi, Universiteti i Tetovës duhet të përshtatet dhe të marrë rol aktiv në këtë transformim.

Zhvillimi i inovacionit, digjitalizimi dhe përdorimi i inteligjencës artificiale janë thelbësorë për modernizimin e universitetit dhe për përgatitjen e studentëve për një treg pune gjithnjë e më konkurrues dhe të bazuar në dije.

Angazhimi im do të jetë që universiteti të kalojë nga një model tradicional në një **institucion "Smart", inovativ dhe të ndërlidhur me zhvillimet globale**, ku teknologjia integrohet në administratë, mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Kjo pikë lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e laboratorëve dhe kërkimit aplikativ (Pika 2), si dhe me ndërkombëtarizimin e universitetit (Pika 1).

### Çfarë do të realizohet konkretisht:

**Universiteti "Smart" - digjitalizim total i proceseve** Do të krijohet një platformë e integruar digjitale (One-Stop-Shop), e cila do të mundësojë menaxhimin e të gjitha shërbimeve universitare përmes një sistemi unik dhe një aplikacioni të dedikuar për studentët dhe stafin, ku çdonjëri do të ketë kartën e identitetit të Universitetit.

- Shërbimet që do të digjitalizohen përfshijnë:
  - notat, regjistrimet dhe pagesat
  - komunikimin me profesorët dhe administratën
  - njoftimet dhe dokumentet zyrtare
  - procesi edukativ dhe kërkimor në tërësi

Kjo do të reduktojë ndjeshëm burokracinë, do të rrisë transparencën dhe do të përmirësojë efikasitetin e funksionimit të universitetit.

### Inkubatori i Biznesit "UT-Hub"

Universiteti do të krijojë një hapësirë të dedikuar për inovacion dhe sipërmarrje, ku studentët dhe të rinjtë do të kenë mundësi të zhvillojnë idetë e tyre në projekte konkrete.

- UT-Hub do të ofrojë:
  - mentorim nga ekspertë dhe profesorë
  - mbështetje për zhvillimin e ideve dhe planeve të biznesit
  - lidhje me investitorë, kompani dhe partnerë ndërkombëtarë
  - krijimin e start-up dhe lançimin e tyre në tregun e lirë

Universiteti nuk do të jetë vetëm vend i mësimin, por edhe vend ku lindin dhe zhvillohen biznese të reja.

## Akademia e Karrierës dhe Inteligjencës Artificiale

Do të krijohen programe të strukturuar për përgatitjen praktike të studentëve në fusha kyçe të së ardhmes.

• **Fokus në:**

- inteligjencë artificiale dhe analiza të të dhënave
- teknologji digjitale dhe transformim teknologjik
- aftësi praktike për tregun e punës

Studentët do të dalin të përgatitur realisht për punësim dhe konkurrues në tregun rajonal dhe ndërkombëtar.

Lidhja me industrinë teknologjike dhe kërkimin shkencor

Në përputhje me Pikën 2 (Universiteti Kërkimor), do të krijohen partneritete të drejtpërdrejta me kompani dhe institucione për:

- praktika studentore dhe trajnim profesional
- projekte të përbashkëta kërkimore dhe inovative
- zhvillim të teknologjive të reja
- mundësi punësimi për studentët

Teknologjia dhe inovacioni do të jenë ura lidhëse mes universitetit, industrisë dhe kërkimit shkencor.

Dimensioni ndërkombëtar i inovacionit

Në lidhje me Pikën 1 (Ndërkombëtarizimi), universiteti do të:

- përfshihet në rrjete ndërkombëtare të inovacionit dhe teknologjisë
- marrë pjesë në projekte evropiane në fushën e IA dhe digjitalizimit
- bashkëpunojë me universitete dhe qendra kërkimore ndërkombëtare
- luajë rol kyç në ndërtimin e qendrave rajonale të ekselencës

Kjo do të rrisë kapacitetet teknologjike dhe konkurrueshmërinë globale të universitetit.

## Rezultati i pritshëm

Përmes kësaj qasjeje:

Universiteti i Tetovës do të bëhet një institucion modern i digjitalizuar

studentët do të jenë më të përgatitur për tregun e punës

do të zhvillohet inovacioni dhe sipërmarrja

do të forcohet lidhja me kërkimin dhe industrinë

do të pozicionohet si një qendër inovative në rajon

SHTYLLA IV

# 4. NDËRLIDHJA ME INDUSTRIJË DHE EKONOMINË

---

Universiteti si partner strategjik i ekonomisë dhe industrisë.



SHTYLLA IV

## 4. NDËRLIDHJA ME INDUSTRIJË DHE EKONOMINË

Universiteti nuk duhet të jetë i ndarë nga ekonomia - ai duhet të jetë pjesë aktive e saj dhe kontribues i drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të vendit. Në një ekonomi moderne, universitetet janë motor i inovacionit, zhvillimit dhe konkurrueshmërisë. Prandaj, angazhimi im do të jetë që Universiteti i Tetovës të shndërrohet në një partner strategjik i sektorit privat dhe zhvillimit ekonomik në nivel lokal, rajonal dhe më gjerë.

Kjo pikë lidhet drejtpërdrejtë me:

- laboratorët dhe kërkimin aplikativ (Pika 2)
- inovacionin dhe sipërmarrjen (Pika 3)
- rrjetin ndëruniversitar (Pika 1)

Çfarë do të realizohet konkretisht:

Shërbime laboratorike dhe ekspertiza profesionale

Në lidhje të drejtpërdrejtë me Pikën 2, laboratorët universitarë do të ofrojnë shërbime të specializuara për bizneset dhe institucionet ekonomike.

- Përmes tyre do të realizohen:
  - analiza laboratorike të avancuara
  - certifikime dhe verifikime sipas standardeve
  - zgjidhje teknike dhe shkencore për problemet e prodhimit

Universiteti do të bëhet një qendër kompetence dhe referimi për industrinë

Projekte të përbashkëta me industrinë

Do të zhvillohen projekte konkrete që adresojnë sfidat reale të bizneseve dhe sektorëve ekonomikë.

- Fokus në:
  - zhvillimin e produkteve dhe proceseve të reja
  - përmirësimin e teknologjive ekzistuese
  - rritjen e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së kompanive

Kërkimi shkencor do të lidhet drejtpërdrejt me nevojat e tregut.

Përfshirja e studentëve në projekte reale

Në përputhje me Pikën 7, studentët do të kenë mundësi të punojnë drejtpërdrejt me kompanitë dhe institucionet.

- Studentët do të përfshihen në:
  - projekte praktike me industrinë
  - praktika profesionale dhe trajnime
  - zgjidhje konkrete për probleme reale

Kjo rrit ndjeshëm mundësitë e punësimit dhe përgatitjen profesionale të tyre.

Projekte rajonale përmes rrjetit ndëruniversitar

Në lidhje me Pikën 1, universiteti do të zhvillojë projekte të përbashkëta rajonale me:

- universitete partnere
- kompani dhe industri në rajon
- organizata dhe programe ndërkombëtare

Kjo rrit kapacitetin për projekte të mëdha dhe financime ndërkombëtare.

Ndikimi ekonomik dhe financiar për universitetin

Ky model bashkëpunimi krijon jo vetëm ndikim akademik, por edhe përfitime konkrete ekonomike për universitetin.

- Përmes këtyre aktiviteteve do të sigurohen:
  - të ardhura nga shërbimet dhe projektet
  - mundësi investimi në laboratorë dhe kërkim
  - mbështetje për zhvillimin e mëtejshëm institucional

Universiteti bëhet më i pavarur financiarisht dhe më i qëndrueshëm.

## Rezultati i pritshëm

Përmes kësaj qasjeje:

Universiteti i Tetovës do të lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik

do të rritet bashkëpunimi me sektorin privat dhe industrinë

studentët do të përfitojnë përvojë reale dhe mundësi punësimi

do të rritet ndikimi i universitetit në shoqëri dhe ekonomi


universiteti do të pozicionohet si një aktor kyç në zhvillimin rajonal

SHTYLLA V

# 5. KAMPUSI MODERN DHE I QËNDRUESHËM

---

Kampus Green & Tech me standarde evropiane.



SHTYLLA V

## 5. KAMPUSI MODERN DHE I QËNDRUESHËM

Një universitet modern nuk matet vetëm me cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit, por edhe me infrastrukturën dhe mënyrën se si menaxhon burimet e tij.

Universiteti i Tetovës duhet të reflektojë standardet e një institucioni evropian edhe në aspektin fizik dhe funksional, duke krijuar një ambient që mbështet zhvillimin akademik, kërkimin shkencor dhe jetën studentore.

Angazhimi im do të jetë ndërtimi i një kampusi që është njëkohësisht **teknologjik, funksional dhe i qëndrueshëm ekologjikisht**, në përputhje me praktikat më të mira evropiane.

Kjo pikë lidhet drejtpërdrejt me:

- zhvillimin e laboratorëve dhe kërkimit (Pika 2)
- digjitalizimin dhe teknologjinë (Pika 3)
- dhe bashkëpunimin me donatorë dhe partnerë ndërkombëtarë (Pika 1)

Çfarë do të realizohet konkretisht:

### Kampusi "Green & Tech"

Universiteti do të implementojë një model të menaxhimit të qëndrueshëm të energjisë dhe burimeve, duke u orientuar drejt një kampusi ekologjik dhe teknologjik.

- Implementimi i:
  - paneleve solare për prodhimin e energjisë së rinovueshme
  - sistemeve moderne për kursimin dhe menaxhimin e energjisë
  - zgjidhjeve inteligjente për menaxhimin e ujit dhe mbetjeve

Universiteti do të bëhet një **model i qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë mjedisore në rajon**, duke ulur kostot dhe duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit.

Investime strategjike në infrastrukturë Për të mbështetur zhvillimin akademik dhe kërkimor, do të realizohen investime të mirëplanifikuara në përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese.

- Do të modernizohen:
  - laboratorët (në funksion të kërkimit dhe shërbimeve profesionale - Pika 2)
  - sallat mësimore (me pajisje digjitale dhe teknologji moderne - Pika 3)
  - hapësirat për studentët (zona studimi, biblioteka, ambiente sociale)

Qëllimi është krijimi i një ambienti që rrit cilësinë e studimit dhe motivimin e studentëve dhe stafit.

### Konferenca e Donatorëve - model i ri financimi dhe partneriteti

Një nga iniciativat më të rëndësishme do të jetë organizimi i një Konference të Donatorëve, e cila do të shërbejë si platformë për mobilizimin e burimeve financiare dhe partneriteteve s strategjike.

- Në këtë platformë do të përfshihen:
  - bizneset vendore dhe rajonale
  - diaspora shqiptare
  - institucionet publike dhe ndërkombëtare

Qëllimi kryesor:

Ndërtimi i objektit të ri modern për Fakultetin e Shkencave të Mjekësisë

Ndërtimi i objektit për Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, zgjerimin e hapësirës ekzistuese të "rektorati i vjetër" si dhe zhvillimi i infrastrukturës kërkimore dhe mësimore.

- Përmes këtij modeli do të krijohen:
  - partneritete afatgjata me sponsorë dhe donatorë
  - mundësi për bashkëfinancim të projekteve
  - angazhim më i madh i komunitetit dhe diasporës në zhvillimin e universitetit

Ky është një model inovativ që e bën universitetin më të hapur, më të lidhur me shoqërinë dhe më të aftë për të realizuar projekte të mëdha zhvillimore.

## Rezultati i pritshëm

Përmes kësaj qasjeje:

Universiteti i Tetovës do të ketë një kampus modern dhe funksional

do të përmirësohen ndjeshëm kushtet për mësim, kërkim dhe jetë studentore

do të reduktohen kostot përmes menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve

do të rritet atraktiviteti për studentë dhe partnerë ndërkombëtarë

do të pozicionohet si një institucion modern evropian


përfitime reciproke për të gjitha palët e përfshira

SHTYLLA VI

## 6. GJUHA, KULTURA DHE DIPLOMACIA AKADEMIKE

---

Gjuha, kultura dhe diplomacia akademike si fuqi institucionale.



SHTYLLA VI

## 6. GJUHA, KULTURA DHE DIPLOMACIA AKADEMIKE

Universiteti i Tetovës ka një mision të veçantë që tejkalon dimensionin akademik - ai është një nga institucionet kryesore për ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e gjuhës, kulturës dhe identitetit shqiptar në rajon.

Në një kohë të globalizimit dhe sfidave kulturore, universiteti duhet të luajë një rol aktiv jo vetëm në edukim dhe kërkim, por edhe në ndërtimin e urave të bashkëpunimit dhe dialogut ndërkulturor.

Angazhimi im do të jetë që Universiteti i Tetovës të shndërrohet në një qendër të rëndësishme të **diplomacisë akademike dhe kulturore**, duke e pozicionuar atë si një referencë në hapësirën shqiptare dhe më gjerë.

Kjo pikë lidhet drejtpërdrejt me:

- ndërkombëtarizimin (Pika 1)
- zhvillimin e projekteve ndërkombëtare
- promovimin e universitetit në nivel global

Çfarë do të realizohet konkretisht:

Promovimi i shumëgjuhësisë dhe bashkëjetesës kulturore

Universiteti do të zhvillojë programe dhe projekte që promovojnë një shoqëri të hapur dhe të bazuar në respekt të ndërsjellë.

- **Do të realizohen iniciativa që:**
  - promovojnë gjuhën shqipe si vlerë akademike dhe kulturore
  - respektojnë dhe integrojnë diversitetin kulturor
  - forcojnë dialogun ndërkulturor dhe bashkëjetesën

Universiteti bëhet një hapësirë ku ndërthuren identiteti dhe moderniteti.

Shkolla verore ndërkombëtare

Do të organizohen programe të strukturuar për studentë të vendit dhe të huaj, të cilat do të kombinojnë studimin akademik me përvojën kulturore.

- **Fokus në:**
  - gjuhën shqipe
  - historinë dhe kulturën shqiptare
  - realitetin shoqëror dhe zhvillimin rajonal

Universiteti i Tetovës do të kthehet në një **destinacion ndërkombëtar për studime shqiptare dhe përvojë akademike**.

### Pritja dhe integrimi i studentëve ndërkombëtarë

Do të krijohen kushte dhe programe të posaçme për tërheqjen dhe integrimin e studentëve të huaj.

#### Do të zhvillohen:

- programe studimore në gjuhë të huaja
- module për studime shqiptare dhe ballkanike
- aktivitete integruese kulturore dhe akademike

• **Do të zhvillohen:**

- programe studimore në gjuhë të huaja
- module për studime shqiptare dhe ballkanike
- aktivitete integruese kulturore dhe akademike

Kjo rrit ndjeshëm ndërkombëtarizimin dhe diversitetin akademik të universitetit.

Laboratori për gjuhësi eksperimentale dhe teknologji të gjuhës

Do të krijohet një qendër moderne kërkimore në fushën e gjuhësisë dhe teknologjisë së gjuhës.

• **Funksionet kryesore:**

- studime të avancuara gjuhësore
- zhvillim i teknologjive të gjuhës (p.sh. përpunimi i tekstit dhe AI -lidhje me Pikën 3)
- kërkim shkencor në linguistikë dhe komunikim

Ky laborator lidh gjuhën me teknologjinë dhe kërkimin modern.

Diplomacia akademike dhe roli rajonal i universitetit

Universiteti do të përdorë gjuhën dhe kulturën si instrument të diplomacisë akademike, duke:

- ndërtuar ura bashkëpunimi me universitete dhe institucione ndërkombëtare
- marrë pjesë në projekte kulturore dhe shkencore të financuara nga BE
- promovuar identitetin dhe vlerat shqiptare në nivel ndërkombëtar

Universiteti bëhet një aktor aktiv në diplomacinë akademike dhe kulturore të rajonit.

## Rezultati i pritshëm

Përmes kësaj qasjeje:

Universiteti i Tetovës do të forcojë rolin e tij si qendër e gjuhës dhe kulturës shqiptare

do të rrisë praninë e studentëve dhe partnerëve ndërkombëtarë

do të zhvillojë projekte të rëndësishme kulturore dhe shkencore

dhe do të pozicionohet si një institucion me ndikim në nivel rajonal dhe evropian

SHTYLLA VII

# 7. STUDENTI NË QENDËR DHE MEDIA UNIVERSITARE

---

Studenti si partner aktiv në jetën universitare.



SHTYLLA VII

# 7. STUDENTI NË QENDËR DHE MEDIA UNIVERSITARE

Studenti është arsyeja kryesore e ekzistencës së universitetit dhe çdo reformë e vërtetë duhet të fillojë dhe të përfundojë tek ai.

Në një universitet modern, studentit nuk duhet të jetë vetëm dëgjues pasiv, por një **pjesëmarrës aktiv në procesin akademik, kërkimin shkencor dhe jetën institucionale.**

Angazhimi im do të jetë që Universiteti i Tetovës të krijojë një ambient ku studentët ndihen të përfshirë, të dëgjuar dhe të motivuar për të kontribuar.

Kjo pikë lidhet drejtpërdrejt me:

- kërkimin dhe laboratorët (Pika 2)
- inovacionin dhe zhvillimin profesional (Pika 3)
- transparencën institucionale (Pika 7)

Çfarë do të realizohet konkretisht:

Themelimi i medias universitare

Do të krijohet një platformë moderne mediatike e universitetit, e cila do të shërbejë si zëri zyrtar dhe i pavarur i komunitetit universitar.

- **Media universitare do të ofrojë:**
  - informim të rregullt për aktivitetet akademike dhe studentore
  - promovim të arritjeve të studentëve dhe stafit
  - hapësirë për diskutim dhe komunikim institucional

Universiteti fiton një kanal të drejtpërdrejtë komunikimi me studentët dhe publikun.

Podcast studentor dhe platforma e zërit studentor

Studentët do të kenë hapësirë të strukturuar për të shprehur mendimet dhe idetë e tyre.

- **Përmes podcastit dhe platformave të tjera:**
  - do të diskutohen çështje akademike dhe sociale
  - do të adresohen problemet dhe sfidat e studentëve
  - do të promovohen iniciativa dhe ide të reja

Kjo krijon një kulturë dialogu dhe rrit ndjeshëm përfshirjen studentore.

Përfshirja e studentëve në kërkim dhe projekte

Në lidhje me Pikën 2 dhe 3, studentët do të integrohen drejtpërdrejt në aktivitetet kërkimore dhe profesionale.

- **Studentët do të jenë pjesë aktive në:**
  - projekte shkencore dhe aplikative
  - analiza laboratorike dhe kërkim praktik
  - projekte me institucione dhe kompani

Kjo rrit ndjeshëm cilësinë e studimit dhe përgatitjen për tregun e punës.

### Zhvillimi personal dhe profesional i studentëve

Universiteti do të mbështesë studentët edhe përtej procesit akademik, duke krijuar mundësi për zhvillimin e tyre të plotë.

- **Do të promovohet:**

- zgjedhja demokratike dhe transparente e përfaqësuesve
- pjesëmarrja në aktivitete akademike dhe sociale
- zhvillimi i aftësive të komunikimit dhe lidhshirësit
- përfshirja në projekte ndërkombëtare dhe inovative

Studenti nuk përgatitet vetëm për diplomë, por për jetë profesionale dhe kontribut në shoqëri.

Rritja e rolit të studentëve në jetën universitare

Do të krijohen mekanizma që studentët të jenë pjesë e proceseve vendimmarrëse dhe zhvillimore.

- **Përmes**

- konsultimeve të rregullta
- përfaqësimit aktiv në strukturat universitare
- përfshirjes në iniciativat strategjike

Universiteti bëhet një institucion ku studentët ndihen pjesë reale e tij.

## Rezultati i pritshëm

Përmes kësaj qasjeje:

Studentët do të jenë më të motivuar dhe më të përfshirë

do të rritet cilësia e studimit dhe përgatitja praktike

do të krijohet një kulturë komunikimi dhe transparence

dhe universiteti do të bëhet një komunitet aktiv dhe dinamik

SHTYLLA VIII

# 8. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

---

Besim, meritokraci dhe llogaridhënie institucionale.



SHTYLLA VIII

## 8. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

Një universitet i fortë ndërtohet mbi besimin.

Besimi ndërtohet mbi transparencën, drejtësinë dhe përgjegjësinë institucionale.

Në një kohë kur kërkohet më shumë hapje dhe llogaridhënie nga institucionet publike, Universiteti i Tetovës duhet të jetë shembull i një institucioni modern, ku çdo vendim dhe çdo proces është i qartë, i drejtë dhe i qasshëm.

Angazhimi im do të jetë për një universitet që funksionon mbi parimin:

"Asgjë nuk fshihet - gjithçka është e qartë dhe e qasshme."

Kjo pikë lidhet drejtpërdrejt me:

- digjitalizimin (Pika 3)
- përfshirjen e studentëve (Pika 6)
- dhe menaxhimin e burimeve (Pika 4)

Çfarë do të realizohet konkretisht:

Platforma "Transparenca UT" - hapje totale institucionale

Do të krijohet një platformë digjitale e dedikuar, ku çdo anëtar i komunitetit universitar dhe publiku do të ketë qasje në informacionet kryesore të universitetit.

• **Në këtë platformë do të publikohen në mënyrë të rregullt:**

- buxheti i universitetit dhe shpenzimet kryesore
- vendimet e organeve drejtuese
- konkurset për punësim dhe avancim akademik
- shpalljet dhe procedurat administrative

Kjo rrit ndjeshëm besimin dhe eliminon paqartësitë dhe keqkuptimet.

Raportim i rregullt publik dhe kulturë e llogaridhënies

Do të vendoset një praktikë e re e raportimit të rregullt dhe të strukturuar për aktivitetet e universitetit.

• **Do të publikohen periodikisht:**

- raportet për aktivitetet akademike dhe institucionale
- projektet e realizuara dhe në zhvillim
- përdorimi i mjeteve financiare dhe investimet

Universiteti do të jetë i përgjegjshëm jo vetëm ndaj ligjit, por edhe ndaj stafit dhe studentëve të tij.

Digjitalizimi i administratës dhe proceseve vendimmarrëse

Në lidhje me Pikën 3 (Universiteti "Smart"), do të realizohet digjitalizimi i proceseve administrative për të rritur efikasitetin dhe transparencën.

• **Kjo do të përfshijë:**

- aplikime dhe procedura online
- ndjekje të proceseve në kohë reale
- reduktim të ndërhyrjeve manuale dhe burokracisë
- Trajnim të vazhdueshëm të administratës

Sa më pak burokraci, aq më shumë transparencë dhe drejtësi.

Forcimi i drejtësisë dhe meritokracisë

Transparenca nuk ka vlerë pa drejtësi.

Prandaj do të vendosen standarde të qarta për:

- procedura të drejta dhe të hapura për punësim dhe avancim
- vlerësim të bazuar në meritë dhe performancë
- shmangie të ndikimeve joprofesionale në vendimmarrje

Qëllimi është krijimi i një universiteti ku secili ndihet i trajtuar drejt dhe me dinjitet.

Përfshirja e komunitetit universitar në vendimmarrje

Në lidhje me Pikën 7, do të forcohet roli i stafit dhe studentëve në proceset vendimmarrëse.

- Do të realizohen:
  - konsultime të rregullta me stafin akademik
  - përfshirje më e madhe e studentëve në diskutime dhe vendimmarrje
  - mekanizma për informacion kthyes dhe propozime

Transparenca nuk është vetëm informim - është edhe përfshirje.

## Rezultati i pritshëm

Përmes kësaj qasjeje:

rritet besimi i stafit dhe studentëve në institucion

përmirësohet cilësia e vendimmarrjes

reduktohen keqkuptimet dhe pakënaqësitë

forcohet imazhi i universitetit si institucion modern dhe i drejtë

## 9. MBËSHTETJA FINANCIARE E PROFESORËVE PËR BOTIMIN E ARTIKUJVE SHKENCORË NË REVISTA ME RENOME NDËRKOMBËTARE

### 9. 1. Përmbledhje ekzekutive

Ky dokument propozon një skemë institucionale të qëndrueshme për rritjen e publikimeve cilësore dhe ndërkombëtarizimin e Universitetit të Tetovës, përmes financimit të synuar për publikime në revista të indeksuara në Scopus dhe/ose Web of Science, si dhe mbështetjes së pjesëmarrjes me prezantim në konferenca ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit]. Programi harmonizon financimin me kontroll financiar, rubrikë vlerësimi meritore dhe mekanizma për integritet akademik.

#### Zbatimi realizohet përmes:

i) Fondit Institucional për Publikime Shkencore (FIPS), ii) Programit të Mobilitetit Akademik në Konferenca (PMAK) dhe iii) Zyrës për Mbështetje të Kërkimit dhe Publikimit (RSO). iv) Rezultatet monitorohen me indikatorë (KPI) dhe raportim publik vjetor.

## 9. 2. Sfondi dhe arsytimi

Publikimi në databaza ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në konferenca me reputacion janë tregues të performancës akademike dhe të reputacionit institucional. Mbështetja e strukturuar rrit cilësinë metodologjike, citueshmërinë, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe kapacitetin për projekte kërkimore. Për të realizuar këtë pikë stafit akademik do t'i mundësohet qasja në platforma dhe biblioteka online, që do të ndihmojë në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor, ndihmojë në publikime në revista ndërkombëtare, do të mbështesë mësimdhënien me literaturë të përditësuar dhe do të mundësojë ndjekjen e standardeve ndërkombëtare akademike. Për Universitetin e Tetovës, një program i standardizuar krijon barazi në qasje, qartësi në kriteret e financimit dhe përdorim të përgjegjshëm të buxhetit.

## 9. 3. Parimet udhëheqëse

**Meritokraci:** financimi jepet mbi bazë pikëzimi dhe rubrike të publikuar.

**Transparencë:** thirrjet, kriteret, rezultatet dhe raportet vjetore publikohen.

**Integritet akademik:** parandalim i plagjiaturës, autorësisë jo-reale dhe manipulimit të të dhënave.

**Cilësi para sasisë:** prioritet outlet-eve të besueshme (peer-review) dhe quartile më të lartë.

**Kontroll financiar:** disbursim në dy faza dhe prova fiskale të lidhura me rezultat.

## 9. 4. Qëllimi dhe objektivat

### 9. 4.1 Qëllimi i përgjithshëm

Të krijohet një sistem institucional që mbështet publikimet Scopus/WoS dhe mobilitetin akademik, duke rritur ndikimin shkencor dhe reputacionin ndërkombëtar të UT.

### 9. 4.2 Objektivat specifike

1. Rritje e publikimeve Scopus/WoS me fokus në cilësi (Q1-Q2).
2. Ulja e barrierave financiare për publikim (APC, redaktim, metodologji) dhe konferenca.
3. Zgjerim i pjesëmarrjes me prezantim në konferenca ndërkombëtare dhe rrjete bashkëpunimi.
4. Standardizim i mbështetjes teknike për shkrim shkencor (RSO) dhe forcim i etikës së publikimit.
5. Monitorim me KPI dhe raportim publik vjetor.

## 9. 5. Përfituesit dhe kriteret e pranueshmërisë

Përfitues janë profesorët, docentët, asistentët dhe stafi akademik i UT.

Përfshirja e doktorantëve/masterantëve si bashkautorë inkurajohet kur kontributi është i dokumentueshëm.

Kushtet minimale: qasje e verifikimit (Scopus/WoS), afilicion UT, dokumentacion i plotë aplikimi dhe deklaratë etike.

## 9. 6. Struktura e programit

### 9. 6.1 Fondi Institucional për Publikime Shkencore (FIPS)

FIPS financon shpenzime të drejtpërdrejta për publikim: APC, proof-reading/academic editing, mbështetje metodologjike/statistikore të arsyeshme dhe përgatitje të figurave kur kërkohet nga revista.

#### Politika e prioritizimit

Financimi diferencohet sipas cilësisë së revistës (quartile/metric): Q1-Q2 (prioritet i lartë), Q3-Q4 (prioritet standard), ndërsa outlet-e pa quartile financohen vetëm me arsyetim strategjik dhe verifikim të plotë të kredibilitetit.

### 9. 6.2 Programi i Mobilitetit Akademik në Konferenca (PMAK)

PMAK mbështet pjesëmarrjen me prezantim (verbal/poster) në konferenca ndërkombëtare. Shpenzimet e pranueshme: regjistrim, udhëtim, akomodim dhe mëditje sipas rregullores. Kusht minimal: letër pranimi dhe program/ueb faqe zyrtare.

### 9. 6.3 Zyra për Mbështetje të Kërkimit dhe Publikimit (RSO)

RSO ofron shërbime praktike: përzgjedhje reviste/konference, formatim, cover letter, menaxhim referencash, feedback para dorëzimit, asistencë për përgjigje ndaj reviewer-ëve dhe këshillim për etikë e integritet të të dhënave.

## 9. 7. Procedurat e aplikimit dhe disbursimit

### 9. 7.1 Thirrjet dhe dokumentacioni

Thirrjet publikohen 3-4 herë në vit. Dokumentacioni: formular, dëshmi indeksimi, draft/punim i pranuar ose abstrakt, parashikim shpenzimesh dhe deklaratë etike.

### 9. 7.2 Vlerësimi dhe vendimmarrja

Komisioni institucional vlerëson sipas rubrikës (Anex 1), me rregull të konflikt interesit. Rezultatet publikohen në mënyrë transparente.

### 9. 7.3 Disbursimi dhe evidenca

Disbursim në dy faza: (i) parapagim pas miratimit; (ii) pagesë finale pas provave fiskale dhe dëshmive të rezultatit (DOI/link publikimi, certifikatë prezantimi).

## 9. 8. Monitorimi, raportimi dhe KPI

Raportim i detyrueshëm brenda 60 ditësh pas publikimit/konferencës dhe raport vjetor publik "Raporti i Ekselencës Kërkimore - UT".

#### KPI kryesorë:

- Publikime Scopus/WoS (ndarje Q1-Q4).
- Pjesëmarrje me prezantim në konferenca ndërkombëtare.
- Bashkautorësi dhe partneritete ndërkombëtare (co-authorship, projekte).
- Pjesëmarrje në trajnime RSO dhe feedback i shërbimeve.
- Tregues të integritetit akademik (kontroll ngjashmërie, raste shkeljesh).

## 9. 9. Integriteti akademik dhe menaxhimi i rrezikut

Programi përjashton outlet-e jo-kredibile dhe aplikimet që nuk kalojnë verifikimin e indeksimit. Shkeljet etike (plagjiaturë, autorësi jo-reale, fabrikim të të dhënave) sjellin masa disiplinore dhe përjashtim nga financimi, sipas rregullores së UT.

## 9. 10. Plani i implementimit

### 9. 10.1 100 ditët e para

- Miratim i rregullores dhe rubrikës së vlerësimit.
- Emërim i Komisionit dhe rregullat e konflikt interesit.
- Funksionalizim i RSO dhe publikim i shërbimeve.
- Hapja e thirrjes së parë për FIPS dhe PMAK.

### 9. 10.2 Brenda 12 muajve

- 3-4 thirrje vjetore dhe disbursim sipas dy fazave.
- Raportim vjetor publik me KPI dhe rishikim i kritereve sipas rezultateve.

## Përfundim

### Përmbledhje ekzekutive

Universiteti i Tetovës ka potencial të qartë për rritje të dukshmërisë dhe ndikimit shkencor, për një rol më të madh në zhvillimin shoqëror, kulturor, ekonomik dhe teknologjik. Në mandatin tim si Rektor, prioritet do të jetë krijimi i një sistemi të qëndrueshëm, transparent dhe meritokratik **për financimin e publikimeve në Scopus/Web of Science dhe mbështetjen e pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare** brenda dhe jashtë vendit. Ky program synon rritje të cilësisë së kërkimit, forcim të integritetit akademik dhe ndërtim të rrjeteve ndërkombëtare që kthehen në projekte, bashkëpunime dhe reputacion institucional.

Si kandidat për Rektor, do të angazhohem që Universiteti i Tetovës të ketë një sistem të qartë dhe funksional për financimin e publikimeve në Scopus/WoS dhe përfaqësimin në konferenca ndërkombëtare të indeksuara në SCOPUS. Ky program e kthen kërkimin shkencor në prioritet real institucional, me standarde të forta transparence, meritokracie dhe integriteti akademik.

Ky program krijon një mekanizëm të qartë dhe të matshëm për të mbështetur publikimet Scopus/WoS dhe konferencat ndërkombëtare, duke rritur cilësinë e kërkimit, ndërkombëtarizimin dhe llogaridhënien institucionale.

Kandidati për Rektor: Prof. Dr. Fehari Ramadani

---

Nënshkrimi


Datë: \_\_\_ / \_\_\_ / 2026

PËRMBYLLJE

# PËRMBYLLJE E PLATFORMËS

---

Nga dokument programor në kontratë morale për transformim institucional.



## PËRMBYLLJE

# PËRMBYLLJE E PLATFORMËS

Kjo platformë nuk është vetëm një listë premtimesh, është një plan i qartë për transformimin e Universitetit të Tetovës në një institucion:

- më të fortë në aspektin akademik
- më të hapur ndërkombëtarisht
- më të lidhur me ekonominë dhe shoqërinë
- dhe më të besueshëm për stafin dhe studentët

Me këtë qasje, Universiteti i Tetovës do të bëhet një universitet modern, konkurrues dhe me ndikim real në zhvillimin e vendit dhe rajonit.

VIZIONI FINAL

# UNIVERSITETI I SË ARDHMES

Një universitet modern, konkurrues dhe me ndikim real në zhvillimin e vendit dhe rajonit.